



Drejtoria për Urbanizëm, planifikim dhe mbrojtje të mjedisit
Odeljenje za Urbanizam, Planiranje i zaštitu sredine

12 . Nr. 18
Rahovec, 10.04.2018

Drejtoria për Urbanizëm, planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit duke shqyrtuar kërkesën **Nderim Hoti nga Ratkoc** me 12Nr.18 të datës 04.04.2018 duke u bazuar në nenin 32 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit nr 03/L-25, të datës 26.02.2009 nenit 5,6,12 dhe shtojcës e Udhëzimit Administrativ për dhënien e Lejes Mjedisore Komunale Nr. 01/2017 të datës 02.05.2017, neneve 3, 4, 5 të Rregullores Komunale për Dhënien e Lejes Mjedisore Komunale 01Nr. 906 të datës 30.03.2016 dhe neneve 3, 21 dhe 44 të Ligjit për Procedurë të Përgjithshme Administrative Nr.05/L-31 të datës 05.05.2016, kjo Drejtori – Sektori për Mbrojtjen e Mjedisit lëshon këtë:

V E N D I M

LEJE MJEDISORE KOMUNALE

I Lejohet kërkesa e **Nderim Hoti nga Ratkoci** e për marrjen e Lejes Mjedisore Komunale për Objektivin shtalla e lopëve qumeshtore P+O Ratkoc ngastra kadastrale nr.130 te evidentura në certifikatën nr.P-7150068-00130-0 te vendi **I** quajtur **Krisne** sipërfaqe 3395.0 m2 tokë bujqësore arë e klasit 4 zona kadastrale Ratkoc.

II. Leje mjedisore komunale do të pushojë të prodhojë efekte juridike nëse parashtruesi i kërkesës ose investitori nuk fillon realizimin e projektin në afat prej **2 viti** nga dita e marrjes të kësaj leje.

A r s y e t i m

Drejtoria për Urbanizëm –Sektori për Mbrojtjen e Mjedisit duke shqyrtuar kërkesën dhe shkresat e lëndës Nr 20 të datës 04.04.2018, procesverbalit (i lejohet kultivimi deri në 50 gjedhe)nga gjendja faktike në terren me nr. 20 të datës 10.04.2018, konstaton se janë plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara me rregullativën në fuqi, prandaj është vendosur sikurse në dispozitiv.

UDHËZIM JURIDIK : Kundër këtij Vendimi - Leje Mjedisore Komunale pala e pakënaqur mund të ushtrojë në afat prej **15** ditë Ankesë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nga dita e dorëzimit të këtij Vendimi - Lejes Mjedisore Komunale, Ankesa dozohet përmes kësaj Drejtorie - Sektorit për Mbrojtjen e Mjedisit, e taksuar **1 Euro**.

Drejtori

Rumir Zhuniqi

